



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  
**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA**  
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

**ZL. Anr.427/2025**

**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP)**, i përbërë nga gjyqtaret; Skender Çoçaj, kryesues, Arsim Hamzaj dhe Kymete Kicaj anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, të parashtruar kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, dega Gjakovë për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore gjatë ditës së votimit, të Zgjedhjeve Lokale në Republikën e Kosovës, për Raundin e dytë për Kryetar të Komunës, të mbajtura me datën 09 Nëntor 2025, në seancën e panelit të mbajtur më 12.11.2025, merr këtë,

## **V E N D I M**

REFUZOHET e pabazuar ankesa ZL.Anr.427/2025, e datës 09.11.2025, e parashtruar nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, dega Gjakovë për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore gjatë ditës së votimit, të Zgjedhjeve Lokale në Republikën e Kosovës, për Raundin e dytë për Kryetar të Komunës, të mbajtura me datën 09 Nëntor 2025.

## **A r s y e t i m**

Me datën 09.11.2025, PZAP-i, ka pranuar ankesën e identifikuar me numër ZL.Anr.427/2025, nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me të cilën pretendon se me datë 09.11.2025, përkatësisht në ditën e zgjedhjeve të balotazhit, në kundërshtim me dispozitat ligjore të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, duke e thyer heshtjen zgjedhore, z. Agon Batusha, në cilësinë e kryetarit të degës së Lëvizjes Vetëvendosje në qytetin e Gjakovës, ka postuar një fotografi, ku në shkrimin mbi atë fotografi bën thirrje për ta votuar kandidatin e kësaj partie z. Ardian Gola. Tutje në ankesë theksohet se fakti se z. Batusha mban pozitë të lartë brenda subjektit politik LVV, dhe përfaqëson interesat e LVV, assesi nuk e justifikon tendencën e tij për të ndikuar tek votuesi për gjatë një periudhe që është e ndaluar në mënyrë shprehimore me ligj e rregullore, andaj vlerësojmë se respektimi i heshtjes zgjedhore është tregues i kulturës demokratike dhe shkelja e saj, nuk paraqet asgjë tjetër, përveç se ajo dërgon mesazhin se interesi partiak vihet mbi parimet demokratike.



Parashtruesi i ankesës konsideron se veprimi i z. Batusha është në kundërshtim me LZP dhe rregulloret zgjedhore, si Rregulloren Nr.07/24, përkatësisht neni 8, konkretisht par 1,5. Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur në cilësinë e provës një link nga rrjeti social facebook.

Në përgjigjen në ankesë nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje theksohet se siç mund të vërehet nga të dhënat e platformës Facebook, postimi është bërë në ora 06:29, pra para hapjes së qendrave të votimit në orën 07:00, moment i cili shënon fillimin ligjor të periudhës së heshtjes zgjedhore. Neni 8, paragrafi 1 i Rregullores Zgjedhore Nr. 07/2024 përcakton se ndalimet e heshtjes zgjedhore zbatohen "nga hapja e qendrave të votimit për votim dhe deri në mbylljen e tyre". Në këtë rast, postimi është bërë para këtij orari dhe, rrjedhimisht, nuk hyn në periudhën e ndaluar. Ky postim ishte shprehje e qëndrimit politik para fillimit të votimit, brenda lirisë së garantuar për shprehje politike, andaj kërkojmë që ankesa të refuzohet si e pabazuar në fakte dhe në ligj.

Paneli pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se :

-Ankesa është e pabazuar.

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjes në ankesë të paraqitur nga subjekti politik LVV, vlerësoj se pretendimet e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, lidhur me shkeljen e pretenduar se me datë 09.11.2025, përkatësisht në ditën e zgjedhjeve të balotazhit, në kundërshtim me dispozitat ligjore të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, duke e thyer heshtjen zgjedhore, z. Agon Batusha, në cilësinë e kryetarit të degës së Lëvizjes Vetëvendosje në qytetin e Gjakovës, ka postuar një fotografi, ku në shkrimin mbi atë fotografi bën thirrje për ta votuar kandidatin e kësaj partie z. Ardian Gola, Paneli i vlerësoj se janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se pasi që nga provat e parashtruar dhe hetimit të bërë nga Paneli është vërtetuar se postimi i fotos në fjalë nuk ka të bëjë në këtë rast me thyerjen e heshtjes zgjedhore, sepse heshtja zgjedhore për Raundin e Dytë për Zgjedhje Lokale për Kryetar të Komunës, ka filluar me datë 09.11.2025, në ora 07:00, ndërsa sipas dispozitës ligjore të nenit 37 paragrafi 1 i LZP-se, përcaktohet se: "*Nga hapja e Qendrave të Votimit për votim, e deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre, u ndalohet secili prej veprimeve si më poshtë: nën paragrafi 1.2. bërja e fushatës në çfarëdo mënyre*", e për rastin konkret postimi lëndor në rrjetin social facebook është bërë më datë 09.11.2025, në ora 06:29 në mëngjes që rezulton të jetë se postimi është bërë 30 minuta para se të fillon heshtja zgjedhore

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: "*Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse*", Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë dhe nga provat e ofruara si dëshmi nga parashtruesi i ankesës, nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur shkelja e pretenduar për të cilën referohet pala ankuese, në ndërkohë që me provat tjera është vërtetuar se ky postim ka ndodhur para hapjes së Qendrave të Votimit. Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 par. 3, neni 118 par.1 të LZP-së, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA  
ZL.Anr.427/2025, datë 12.11.2025

Kryesues i Panelit,  
Skender Çoçaj



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.